



Qendra ABA
është zëri i
fermerëve
shqiptarë!

abaonline.al

Regjistrimi në ABA Online
ju ofrojmë:

Qendra ABA është zëri i fermerëve shqiptarë!

Faqe 6

Shoqata e Eksportuesve,
Këshilli i Agrobiznesit
Shqiptar dhe Sindikata
e Fermerëve, Letër
të hapur Qeverisë
për mbështetjen
e fermerëve

Faqe 4

Shqipëri-Kosovë,
rritje eksporteve
bujqësore duke
eliminuar çdo hallkë
burokracie

Faqe 6



AGROBIZNESI

FED
invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15 ditëshi i dytë i muajit nëntor 2021

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 426
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

KASH: TË RRIKET BUXHETI PËR BUJQËSINË, TË UNIFIKOHET TVSH-JA KËSHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR I PARASHTRON QEVERISË DISA VLERËSIME, ARGUMENTE E PROPOZIME, PËR RISHIKIMIN E P/BUXHETIT DHE PAKETËS FISKALE TË VITIT 2022, PËR MBZHR

KASH i kërkon Qeverisë - Të rritet shuma totale e parashikuar në P/Buxhetin e vitit 2022, për: Investimet e brendëshme, menaxhimin e qëndrueshëm të tokës, peshkimin dhe sigurinë ushqimore. Gjithashtu agrobiznesi kërkon unifikimin e TVSH-së në blerjen dhe shitjen e prodhimit

RISI ALBANIA

Këshilla për Bizneset e Vogla (ASB), financuar nga BE

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

RisiAlbania Partner for Growth

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Faqe 2



Mbështetje nga JICA, Shqipëria krijon hartat digjitale topografike

Faqe 7

ARRORËT

Bajamja, kjo mrekulli që "sakrifikon"

Përgatiti: Koço Mosko

"Ra dielli në bajame, ba moj bajame!
Ja rritu ja thahu fare, ba moj bajame...!"
Popullore

Faqe 13

KËNDI I EKSPERTIT

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË,
SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

Faqe 11, 12

LEGJISLACION

Paketa Fiskale, 30 mln euro kosto tek biznesi dhe qytetarët

Propozimet në Paketën e re Fiskale 2022-2025 synojnë të rrisin të ardhura shtesë në rreth 3.6 miliardë lekë (30 milionë euro), të cilat më së shumti do të merren mbrapsht nga...

Faqe 2

TASE GROUP

Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra "Kondor", Tiranë;
Cel.: 0672035581; 0684855580

PËRSHËRJE MOTORIKE
FREKSIONE
PERMISTOPA
KUSHINETA
BRIPI
AKSE
PËRSHËRJE ELEKTRIKE
PËRSHËRJE HIDRAULIKE
VAJRA DHE FILTRA

Koyo bepco FAG

RISI ALBANIA

Këshilla për Bizneset e Vogla (ASB), financuar nga BE

“Agrobiznesi në Shqipëri: Kontraktimi në Bujqësi, Zinxhiri i Vlerës dhe Aksesit në Tregje”

BERZH Këshilla për Bizneset e Vogla (ASB), financuar nga BE Western Balkans Enterprise Development and Innovation Facility (WB EDIF) dhe RisiAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, janë dy entitete që kanë bashkuar forcat dhe energjitë e tyre për të mbështetur sektorin e agrobiznesit në Shqipëri përmes mbështetjes financiare dhe asistencës teknike.

rëndësishëm për Agrobiznesin ku ishin të pranishëm përfaqësues nga institucione të rëndësishme, organizata e grupe interesi, ishin çështje të tilla si: Pse duhen këto kontrata? Cili është roli i tyre mbi zinxhirin e vlerës për sektorin e agrobiznesit? Cilat janë problematikat kryesore? Pse është i


zhuar të mbështesë kompanitë që operojnë në sektorë strategjik të ekonomisë shqiptare siç është agrobiznesi dhe turizmi, prodhimi vendas, mbështetja e bizneseve të drejtuara nga gratë, përfshirja e të rinjve në sipërmarrje si dhe investimet e gjelbërta dhe idetë inovative”.

publike, për të aksesuar tregje me vlerë të lartë nëpërmjet adoptimit të standardeve më të kërkuara, sikurse është standardi GlobalGap dhe modeli i

certifikimit në grup”.

“Risi Albania do të vazhdojë të mbështesë në këtë drejtim dhe në fazën e III (2021-2025) të tij”, tha Muedini.

Ky Seminar u organizua nga BERZH Këshilla për Bizneset e Vogla (ASB) financuar nga EU Western Balkans Enterprise Development and Innovation Facility, në bashkëpunim me RisiAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.



“Agrobiznesi në Shqipëri: Kontraktimi në Bujqësi, Zinxhiri i Vlerës dhe Aksesit në Tregje” - ishte webinarin i radhës që organizojë BERZH së bashku me partnerët e tij mbi rëndësinë e “Kontratave Bujqësore”.

Fokus i këtij takimi të

rëndësishëm certifikimi?

Eksptertët e pranishëm i dhanë përgjigje këtyre pyetjeve së bashku me dëshmitë e disa prej praktikave më të mira të eksportit.

Ndërkohë që Ardiola Hristic, menaxhere e programit tha: “BERZH mbetet i anga-

Edlira Muedini, menaxhere e projektit RisiAlbania theksoi: “RisiAlbania, projekti i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, ka mbështetur në 2-3 vitet e fundit përpjekjet e përbashkëta të eksportuesve, fermerëve dhe institucioneve

AGROBIZNESI NË SHQIPËRI

KONTRAKTIMI NË BUJQËSI, ZINXHIRI I VLËRËS DHE AKSESI NË TREGJE

BERZH mbetet i angazhuar të mbështesë kompanitë që operojnë në sektorë strategjikë të ekonomisë shqiptare siç është agrobiznesi dhe turizmi, prodhimi vendas, mbështetja e bizneseve të drejtuara nga gratë, përfshirja e të rinjve në sipërmarrje si dhe investimet e gjelbëra dhe idetë inovative.

Ardiola Hristic, Menaxhere Programi BERZH, Këshilla për Bizneset e Vogla

RisiAlbania, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC ka mbështetur në 2-3 vitet e fundit përpjekjet e përbashkëta të eksportuesve, fermerëve dhe institucioneve publike për të aksesuar tregje me vlerë të lartë nëpërmjet adoptimit të standardeve më të kërkuara, sikurse është standardi GlobalGap dhe modeli i certifikimit në grup. RisiAlbania do të vazhdojë të mbështesë në këtë drejtim dhe në fazën e III (2021-2025) të tij.

Edlira Muedini, Menaxhere Projekti RISI ALBANIA

Propozimet në Paketën e re Fiskale 2022-2025 synojnë të rrisin të ardhura shtesë në rreth 3.6 miliardë lekë (30 milionë euro), të cilat më së shumti do të merren mbrapsht nga sektori i bujqësisë, i cili aktualisht vuan nga kosto të larta të prodhimit, pikërisht prej mbështetjes së ulët që merr nga qeveria.

Disa ndryshime në taksimin e pagave pritet të sjellin efekte pozitive për përfituesit. Kufiri minimal i pagës së patak-sueshme u bë 40 mijë lekë, nga 30 mijë aktualisht, për pagat deri në 40 mijë lekë teksa kufiri i taksimit me 23% do të aplikohet për pagat mbi 200 mijë lekë në muaj nga 150 mijë lekë aktualisht. Qeveria synon që të kthejë mbrapsht tek qytetarët rreth 1.3 miliardë lekë (10 mln euro),

Por një masë e re, që synon të indeksojë nivelin e akcizës me inflacionin vit pas viti, pritet të sjellë një rritje graduale të çmimeve në të gjitha mallrat që taten me akcizë si karburantet, kafeja, birra dhe cigaret. Nëse niveli i inflacionit mesatar kalon këtë vit mbi 2.5%, akciza e naftës rrezikon të arrijë në 38 lekë vitin që vjen nga 37 lekë aktualisht. Gjithashtu një kalendar i ri i akcizës për cigaren do të

Paketa Fiskale, 30 mln euro kosto tek biznesi dhe qytetarët

Që në vitin e parë të zbatimit (korrik-dhjetor 2022) projekt-paketa e re fiskale 3-vjeçare synon të rrisë arkëtimet shtesë tek qytetarët në të paktën 30 milionë euro. Bujqësia, sektori më i goditur, qeveria heq përjashtimet e akcizës dhe TVSH-së. Lehtësohet taksimi i pagave, u zgjeruan kufijtë për pagat ulëta dhe të larta. Të gjitha ndryshimet

funksionojë deri në vitin 2025 ku parashikohet rritje e përvitshme e akcizës dhe përfshirja në taksim edhe e nargjileve ose shishave.

Ndryshimet në ligjin e akcizës hoqën përjashtimet për jahtet, ndaj të cilëve do të aplikohet një taksë 65 lekë për litër karburant. Përjashtimi nga akciza u hoq edhe për serrat me ngrohje me arsyetimin se fermerët nuk e kishin konsumuar këtë masë. Ndryshimet fiskale pritet të rrisin më tej kostot në bujqësi, sidomos në çmimet e plehrave bujqësore, të cilat janë shtrenjtuar me mbi 40% vitin e fundit si rrjedhojë e rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Gjithashtu kufiri i importit pa TVSH të makinerive shkon në 500 milionë lekë nga 50 milionë lekë.

Ndryshimet e kanë ndërlikuar më tej skemën për bujqësinë. Në vitin 2019, skema e kompensimit për prodhuesit nga 20% u bë 6%. Kjo masë uli interesin për përpunuesit,

sidomos ata të qumështit që të furnizoheshin nga tregu vendas dhe shtuan importet për qumështin pluhur, të cilin fabrikat e përdorin në proceset e tyre të prodhimit.

Me paketën e re fiskale, qeveria mori masa që e përkeqësojnë më tej klimën e biznesit në përpunimin e bulmetit. Bërja 0% e kompensimit nga 6% që është aktualisht rëndon më tej kostot. Ministria e Financave tha se do të rrisë mbështetjen me masa direkte nëpërmjet subvencioneve, por në buxhetin e vitit 2022 nuk ka të dhëna të dukshme për këtë masë.

Hiqet rimbursimi për serrat me ngrohje

Ndryshimet në ligjin e akcizës propozojnë heqjen e rimbursimit për lëndët djegëse të konsumuara në serrat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit të produkteve në këta

sektorë (farmaceutika, tullat, çimento, birra dhe nafta bruto).

Aktualisht, ligji parashikon rimbursimin për lëndët djegëse të konsumuara në serrat me ngrohje, për industrinë dhe agroindustrinë. Konkretisht, nga të dhënat rezultojnë se, nga kjo skemë rimbursimi ka përfituar vetëm industria, pasi për agroindustrinë nuk ka gjetur zbatim, si rezultat i moskërkesës së subjekteve për të përfituar nga ky rimbursim, arsyetoi Ministria e Financave.

Sipas të dhënave, janë 11 subjekte përfituese nga kjo skemë rimbursimi për vitet 2020-2021, të cilët rezultojnë të jenë pjesë e industrisë hidrokarbure, tullave dhe asaj farmaceutike. Efekti i parashikuar në buxhetin e shtetit është +800 milionë lekë.

Heqja e përjashtimeve nga TVSH-ja godet bujqësinë, qeveria merr mbrapsht 20 mln euro në vit
Duke marrë në konsider-

atë disa nga këshillat e FMN-së, Qeveria vendosi të marrë mbrapsht disa nga përjashtimet fiskale që kishte dhënë ndaj biznesit, shumica e tyre në sektorin e bujqësisë. Nga heqja e përjashtimeve fiskale, qeveria pritet të rikthejë në buxhet gjatë një viti rreth 2.5 miliardë lekë. Sipas projektligjit të ri për ndryshimet në TVSH, bëhen ndryshimet e mëposhtme.

1- Trajtimin me shkallë të reduktuar të TVSH-së prej 10% të furnizimit të inputeve bujqësore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuar në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinarur të Mallrave nga zero për qind që ishin aktualisht.

2- Përjashtimin nga TVSH-ja për importimin e makinerive dhe pajisjeve në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë, ose më të madhe se 500 milionë lekë nga 50 milionë lekë që është aktualisht.

3- Zëvendësimin e normës

së kompensimit të prodhuesit bujqësor prej 6% në 0%.

Ministria e Financave i arsyetoi ndryshimet me faktin se subjektet që ofrojnë furnizime me inpute bujqësore nuk mund të zbrisin TVSH-në e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import, të kryera në funksion të furnizimit të përjashtuar, ndryshe nga subjektet që kryejnë furnizime të tatueshme dhe mund të zbrisin TVSH-në e paguar në blerje.

Ministria e Financave argumentoi se heqja e skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë do të zëvendësohet me subvencionim direkt të sektorit të bujqësisë, procedurë që është më e lehtë për t'u monitoruar dhe për t'u kontrolluar nga pikëpamja fiskale.

Me anë të këtij projektligji, propozohet që, norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor të bëhet 0% nga 6% aktualisht. Kjo, pasi edhe nga zbatimi në praktikë i dëritanishëm, mendohet se nga skema e kompensimit, prodhuesit bujqësorë objekt të kësaj skeme, nuk kanë marrë kompensimin sikundër është parashikuar dhe ka synuar kjo skemë, duke e bërë këtë të fundit jofunksionale.

KASH: TË RRIKET BUXHETI PËR BUJQËSINË, TË UNIFIKOHET TVSH-JA

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar i parashton Qeverisë disa vlerësime, argumente e propozime, për rishikimin e P/Buxhetit dhe Paketës fiskale të vitit 2022, për MBZHR

I. Projekt Buxheti:

Projekt buxheti i vitit 2022 i propozuar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, për MBZHR është 2 % më i ulët se ai i vitit 2021. Buxheti Vitit 2021 ishte 12. 980. 332, P/buxheti vitit 2022 është propozuar 12.736.369, (shifrat janë në /000/lek).

Propozimi ynë është: P/Buxheti MBZHR duhet rishikuar duke e rritur shumë, veçanërisht në ato kapituj që janë parashikuar me ulje të ndjeshme. Propozimi bazohet në faktin që:

1. Mazhoranca që qeverisë aktualisht vendin në strategjinë e miratuar të bujqësisë dhe zhvillimit rural, por edhe publikisht K/Ministri ka deklaruar disa herë se: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural kanë qenë dhe do të jenë sektor prioritar. Gjithashtu Paketa fiskale nuk do të ndryshojë pa u studiuar, pa u diskutuar dhe pa u konsultuar paraprakisht me përfaqësuesit e sektorit privat, të shoqatave dhe grupet e interesit.

Në fakt:

- Ulja e buxhetit krahasuar me një vit më parë për MBZHR bie ndesh si me strategjinë e miratuar dhe me deklaratat dhe premtimet e K/Ministrit.

- P/buxheti dhe propozimet për Paketën fiskale të vitit 2022, nuk janë mbështetur në studime të kohëve të fundit, nuk është vlerësuar realisht situata aktuale në terren, nuk janë diskutuar e ballafaquar paraprakisht me grupet e interesit dhe përfaqësuesit e shoqatave që operojnë në këtë sektor.

- Informimi për sektorin privat nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë filloi në datën 2 nëntor 2021, mbasi ishte miratuar në qeveri drafti për P/Buxhetin dhe Paketën fiskale për vitin 2022.

- Shkelja e këtyre procedurave me shumë rëndësi për hartimin dhe miratimin e P/Buxhetit dhe Paketës fiskale të vitit 2022 e kanë gjetur të papërgatitur dhe e kanë zënë në befasi sektorin privat, i cili e ka të pamundur për të përballuar një shumë prej 1.75 miliard lek shtesë, që duhet të paguajë duke reduktuar ndjeshëm mjetet e xhiros. Gjithashtu nuk ka parashikuar në programet dhe plan bizneset e veta dëmet që shkaktohen dhe kostot shtesë që duhen përballuar nga një P/buxhet i reduktuar dhe me taksat, tatimet e tarifatat shtesë, që propozohen në Paketën fiskale për vitin 2022.

- Impakti financiar pozitiv në buxhet që pretendohet sipas përlllogaritjeve të hartuesve të Paketës fiskale parashikohet rreth 1 miliard e 750 milion lek të reja.

- Por hartuesit P/buxhetit dhe Paketës fiskale nuk kanë studiuar dhe nuk janë ballafaquar me sektorin privat, për të llogaritur edhe pasojat negative dhe dëmin që i shkaktohet sektorit privat, veçanërisht sektorit prodhues nga reduktimi buxhetit dhe taksat, tatimet e tarifatat shtesë që propozohen në Paketën fiskale. Sipas parashikimeve dhe vlerësimit paraprak të ekspertëve tanë efektet negative në sektorin privat, por edhe në buxhet nga masat e propozuara janë pa dyshim shumë më të mëdha se sa shifra që parashikohet se mund të përfitohet në buxhet nga masat e propozuara:

Propozimi ynë është: Taksat, tatimet dhe tarifatat shtesë të propozuara në Paketën fiskale që shoqëron P/Buxhetin e vitit 2022 të mos hyjnë në fuqi, pa u përfunduar studimi dhe pa u ballafaquar me sektorin privat mbi efektet negative, që do të reflektojnë masat e propozuara në të gjitha hallkat e zinxhirit të Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri dhe për rrjedhojë edhe në buxhetin e shtetit.

Bazuar në shifrat e propozuara në P/buxhetin e MBZHR për vitin 2022 ekspertet tanë kanë parashikuar që:

A) **Investimet e brendshme** në total krahasuar me

2021 do të ulen me mbi 20 %, kurse

Investimet e huaja do të ulen mbi 23 %.

P/buxheti për MBZHR për vitin 2022, goditjen më të madhe për investime do t'i japë infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, që parashikohen të ulen me mbi 55 %. Investime të huaja për infrastrukturën e ujitjes krahasuar me 2021 nuk do të ketë fare, pra nga 100 % shkojnë në 0 % në 2022.

Parashikimi për ndërtimin e veprave të reja të ujitjes dhe kullimit në vitin 2022 do të jetë tejte i limituar. Shumë fonde do të përdoren nga buxheti vitit 2022 për llogari të investimeve në procese të kryera më parë dhe të pafinancuara në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit.

B) **Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës**, ka patur në vite një shifër minimale dhe parashikohet nga ekspertët tanë që edhe gjatë vitit 2022, do të jetë në të njëjtat nivele me vitin e kaluar.

Konsolidimi tokës është një proces me shumë rëndësi për zhvillimin rural për të cilin janë parashikuar 20 milion lek. Ekspertët kanë llogaritur se do të duhen shumë vite për të realizuar objektivin e konsolidimit të tokës me këto fonde që programohen në buxhet.

C) **Menaxhimi i Peshkimit**, parashikohet të pësojë një ulje me mbi 30 % dhe të gjitha këto parashikohen në investimet e brendshme dhe ato të huaja.

D) **Siguria ushqimore** nuk parashikohet të ketë rritje në total, por parashikohet një ulje e lehtë e shpenzimeve.

Propozimi ynë është: Të rritet shuma totale e parashikuar në P/Buxhetin e vitit 2022, për të gjithë kapitujt që përmendëm më sipër duke programuar për secilin kapitull më shumë fonde për vitin 2022 se sa ato të vitit 2021.

II. Paketa fiskale:

2. **Inputeve bujqësore u shtohet një tatim prej 10 % TVSH.** Tatimi shtohet pikërisht në një kohë kur çmimet e imputeve që përdorin fermerët janë rritur ndjeshëm në tregun ndërkombëtar dhe nuk dihet akoma prognoza se ku do të ndalet kjo rritje.

Është llogaritur një përfitim 900 milion lek në buxhet nga kjo masë. Nga informacionet që Ne kemi kompanitë importuese kanë importuar dhe sipas kontratave po vazhdojnë të importojnë inpute me regjimin aktual të TVSH. Kështu që llogaritjet e bëra për efektet pozitive në buxhet pa u konsultuar paraprakisht me sektorin privat dhe pa e vlerësuar realisht situatën në terren nuk janë të sakta.

Propozuesit e kësaj mase nuk e kanë llogaritur dëmin që u shkaktohet fermerëve dhe gjithë sektorit nga kjo masë. Po vijmë dhe do vazhdojmë të jemi akoma në një periudhë krize. Në këtë situatë duhej llogaritur dëmi që u shkaktohet prodhuesve në bujqësi dhe në të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor. Propozimi i kësaj mase pikërisht në këtë periudhë krize, mbas tërmetit, mbas pandemisë, pas dëmeve të shkaktuara nga kushtet e këqia atmosferike dhe mbas rritjes së ndjeshme të çmimeve të mallrave të importuara si rezultat i konjunkturës ndërkombëtare, nuk na rezulton dobiprurës për të rritur të ardhurat e buxhetit të vitit 2022. Propozimi do të favorizojë disa kompani që kanë gjendje malli, të cilat do të justifikojnë edhe rritjen e çmimit të imputeve duke dëmtuar konkurrencën e ndershme edhe rregullat e funksionimit të tregut të lirë.

Propozimi ynë është: Të shtyhet zbatimi i kësaj mase për vitin 2023.

3. Propozim tjetër në Paketën fiskale është që: **Prodhimeve të fermerëve vendas u hiqet fare edhe rimbursimi prej 6 % i TVSH që kanë patur deri tani dhe u bëhet zero rimbursimi TVSH për vitin 2022.**

Për këtë propozim nuk ka ndonjë studim se sa negativisht do të ndikojë kjo masë në procesin e formalizimit të fermerëve dhe reduktimit të informalitetit. Propozuesit e heqjes së rimbursimit të TVSH nuk kanë nxjerrë konkluzionet e duhura dhe nuk kanë llogaritur dëmin që iu shkak-

tua fermerëve dhe gjithë hallkave të zinxhirit ushqimor në tërësi në Shqipëri dhe pasojat negative që solli veçanërisht në blegtori ulja e rimbursimit të TVSH nga 20 % në 6%.

TVSH ka qenë dhe mbetet një instrument me shumë rëndësi për formalizimin e fermerëve. Heqja e këtij instrumenti do t'i japë një goditje të madhe procesit të formalizimit dhe luftës kundër informalitetit. A e kanë menduar propozuesit se Qendrat tona të grumbullimit, në se aprovohet ky propozim i heqjes së rimbursimit të TVSH për Fermerët Shqiptarë, këto qendra do të kthehen nga grumbullues të prodhimeve të fermerëve vendas në importues të produkteve bujqësore të fermerëve të rajonit dhe më gjerë? I duhet dhënë një përgjigje e ndershme edhe pyetjes në vijim: Pse një subjekt privat, në një ekonomi tregu të lirë, do të blejë tek Fermeri Shqiptar lëndë të para dhe produkte, që janë më të shtrenjta dhe nuk u rimbursohet TVSH, kur të njëjtat do t'i gjente më lirë në import, në vendet e rajonit dhe më gjerë, të cilat edhe për arsye të suvenconimit më të madh rezultojnë më të lira dhe u rimbursohet edhe TVSH me 20 %?

Propozimi ynë është: Të bëhet një studim dhe diskutim real me grupet e interesit mbi situatën e TVSH. Si dhe të unifikohet TVSH në blerje dhe në shitje.

4. **ndustrisë së përpunimit të qumështit i vendoset një taksë e re 100 lek/kg (të reja) për qumështin pluhur,** i cili përdoret si lëndë e parë, për realizimin e proceseve teknologjike, të përpunimit të qumështit, si dhe për prodhimin e produkteve analoge, që kanë si lëndë të parë edhe qumështin pluhur. Arsyetimi se me këtë masë që kanë propozuar do të mbështeten prodhuesit vendas të qumështit të freskët nuk ka asnjë bazë. Nga ana tjetër, a mund të më thonë propozuesit që kanë hartuar këtë Paketë fiskale se: A ka ndonjë subjekt vendas në Shqipëri që prodhon qumësht pluhur dhe duhet përkrahur si prodhues vendas?

Shqipëria veçanërisht këto dy vitet e fundit ka filluar të importojë sasi të konsiderueshme dhe me tendencë në rritje të vazhdueshme të qumështit të freskët. Gjithashtu importon proteine hurrë, kazeinë qumështi, sasi të konsiderueshme prodhimesh bulmeti analoge. Pse për këto produkte që janë realisht konkurruese të prodhuesve vendas dhe përpunuesve të qumështit nuk kanë studiuar, parashikuar e propozuar një tarifë ekstra në doganë, por vetëm për qumështin pluhur pa yndyrë?

Gjithashtu nuk janë llogaritur as sa do të rriten kostot tek prodhuesit dhe çmimet për konsumatorët nga kjo tarifë e re. Nëse realisht duhet filluar procesi për të vendosur një tarifë ekstra në import në fushën e blegtorisë janë medikamentet veterinarë, specifiku për Antibiotikët. Të cilët realisht kanë njohur një rritje kohët e fundit. Shumë vende edhe nga ato të BE e përdorin këtë masë, për të frenuar përdorimin pa kriter të Antibiotikëve në kuadër të forcimit të sigurisë ushqimore të produkteve blegtorale.

Propozimi ynë është: Të fillojë studimi për vendosjen e një tarifë për importin e antibiotikëve dhe të mos miratohet tarifa 100 lek/kg për qumështin pluhur pa u përfunduar studimi dhe argumentimi i kësaj tarife.

Koha prej dy ditësh që u njohëm me këto propozime nuk na ka mjaftuar për të llogaritur realisht dëmet që do i shkaktojnë sektorit privat në radhë të parë, por për rrjedhojë edhe buxhetit të shtetit propozimet e bëra në P/Buxhetin dhe Paketën fiskale të vitit 2022. Sapo ky studim e vlerësim të përfundojë do t'jua dërgojmë menjëherë në komision.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm!

Agim Rrapaj

Kryetar i Keshillit Agrobiznesit Shqiptar (KASH)

SINDIKATA E FERMERËVE

Sindikata e Fermerëve, kundër paketës fiskale; Të mbjellat kanë rënë me 30%, kërkesat për të nxitur prodhimin vendas

Shoqata e Eksportuesve, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar dhe Sindikata e Fermerëve, Letër të hapur Qeverisë për mbështetjen e fermerëve

LETËR

Drejtuar: Kryeministrit të Shqipërisë, Z. Edi Rama

Për dijeni: Ministres së Financave, Znj. Delina Ibrahimaj

Për dijeni: Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Znj. Frida Krifca

Z. Kryeministër, kjo letër është hartuar nga tri organizata, që janë të lidhura ngushtësisht, jo vetëm me aktivitetin bujqësor, por dhe me veprimtarinë në të gjitha hallkat e tjera të Ekonomisë së Ushqimit në vendin tonë si: Blegtoria, Peshkimi dhe Akuakultura, Agrobiznesi, Agropërpunimi, Bimët Mjekësore, Aromatike dhe Bletaria, Agroturizmi, Agropylltaria dhe Mjedisi në Zonat Rurale, Tregjet Agro Blegtorale, si dhe Institucione të Mikrofinancës, që kryesisht operojnë në zonat rurale. Ne përballemi çdo ditë me vështirësi e probleme dhe realisht jemi shumë të interesuar për përmirësimin e situatës aktuale dhe zhvillimin me ritme më të shpejta të kësaj fushe.

Ne i vlerësojmë përpjekjet e qeverisë Suaj për zhvillimin e bujqësisë, si një nga hallkat kryesore të Ekonomisë së Ushqimit në dy mandatet e para dhe Ju garantojmë një partneritet të sigurtë, por dhe oponencën tonë konstruktive edhe në mandatin e tretë.

Organizatat tona kanë arritur në konkluzion se, për të bërë realitet objektivin e deklaruar nga ana Juaj, që Shqipëria të arrijë të eksportojë një miliard euro prodhime nga fusha e Ekonomisë së Ushqimit. Gjithashtu të avancojë rezultatet e arritura deri tani, për disbursimin e fondeve grant nga Programi financimit IPARD II, duhet fokusuar më mirë se deri më sot në përmirësimin e punës së bërë, për procesin e Kooperimit dhe Koordinimit, të Fushës së Mekanizimit, Inovacionit dhe Dixhitalizimit, të Financimit dhe Disbursimit të Fondeve Grant, si dhe Përmirësimit të Legjislacionit dhe akteve Nënligjore.

Synimi ynë kryesor që Ne vendosëm Tju drejtohem Ju është:

Formalizimi i propozuar në formën e subvencionimit të drejtpërdrejtë të fermerëve për njësi prodhimi të provuar me faturë tatimore është provuar si metodë efikase dhe e drejtë për nxitjen e zhvillimit bujqësor, në kushtet e një tregu rajonal e ndërkombëtar të influencuar nga politikat subvencionuese të shteteve të ndryshme. Kjo politikë nuk mund të quhet “ndihmë sociale” vetëm pse shumica e përfutur nga fermerët është relativisht e vogël, pasi efekti i saj është tërësisht i kundërt nga ndihma sociale. Kështu nxitet vetëpunësimi, ndërmarrja private, prodhimi kombëtar dhe konkurrenca sipas rregullave të tregut.

Garantimi i Sigurisë Ushqimore, nëpërmjet vlerësimit dhe mbështetjes së procesit të analizave laboratorike dhe certifikimit, ngritjes së mekanizmave eficientë për gjurmueshmërinë, kontrollit të përdorimit të pesticideve, kontrollit të shëndetit të kafshëve dhe ushqimit të blegtorisë, reduktimit të përdorimit të insekticideve dhe pesticideve në bujqësi, reduktimit të antibiotikëve në blegtori dhe të gjitha këto do të ndikojnë e shkojnë në dobi të shëndetit publik. Të gjitha sa më sipër do të ndikojnë pozitivisht edhe në krijimin e kushteve optimale, për garantimin e shitjes së prodhimeve Shqiptare në tregjet me çmime me interes për eksportuesit tanë.

Situata aktuale në të cilën ndodhet Bujqësia, por edhe të gjitha hallkat e zinxhirit të Ekonomisë së Ushqimit nuk po na rezultojnë në nivelin e pritshmërive. Pjesa më e madhe e operatorëve parashikojnë ta mbyllin vitin 2021 me rezultate jo të mira krahasuar me sektorët e tjerë. Gjithashtu krahasuar me planet e tyre të biznesit, me potencialet dhe mundësitë reale që egzistojnë.

Konstatojmë me keqardhje se edhe Paketa Fiskale dhe P/Buxheti vitit 2022 nuk do të garantojnë frenimin e rënies në disa sektorë, si p.sh. tek Akuakultura, Blegtoria, Tregjet Agro Blegtorale, Agropërpunimi, Agroturizmi, Agropylltaria dhe Mjedisi në zonat rurale. Gjithashtu nuk do të garantojë as qendrueshmërinë dhe rritjen në disa sektorë të tjerë, që kanë performuar më mirë si Frutat, Perimet, Peshkimi, Agrobiznesi, Bimët Mjekësore, Aromatike dhe Bletaria si dhe Mikrofinanca.


Në gjykimin tonë, disa tregues do të jenë edhe më negativë në vitin 2022, pasi vërejmë 30% më pak mbjellje dhe rritje galopante të kostove të prodhimit, si pasojë e krizës globale të rritjes së çmimeve.

Nuk është e drejtë që sektori ynë që kontribuon me 20% të PBB dhe ku janë të punësuar 40% e forcës së aftë për punë, të përfitojë vetëm 2% të shpenzimeve të buxhetit.

Ne ju kerkojmë që të rishikohet në rritje për vitin 2022 P/Buxheti për MBZHR dhe Projekti për Paketën e re Fiskale të pezullohet deri në përfundim të vlerësimit të situatës, të studimeve dhe konsultimit me grupet e interesit.

Propozimet tona bashkëlidhur kësaj letre synojnë që nëpërmjet formalizimit të transaksioneve në sektorin e bujqësisë të rriten jo vetëm shpenzimet buxhetore, por edhe të ardhurat në buxhetin e shtetit minimalisht në raportin një me dy.

SHOQATA E EKSPORTUESVE KËSHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR SINDIKATA E FERMERËVE



EFEKT I PROPOZIMEVE TONA NË RAPORTIN E VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi dhe zbatimi i propozimeve tona parashikohet të sjellë efekte financiare pozitive në buxhetin e shtetit, të cilat sipas zërave të paraqitura në formë tabele, vijnë si më poshtë:

Nr.	Propozimi	Efekti financiar në buxhetin e shtetit
1	Nga subvencionimi direkt i fermerëve që kultivojnë perime të freskëta, prodhimimi vjetor për vitin 2020 sipas INSTAT dhe MBZHR ishte 874,947 ton. Duke subvencionuar me minimalisht 10 lekë/kg:	- 8,749.5 mil lekë/vit - 71 mil euro/vit
2	Stimuli dhe mbrojtja nga risku i eksportuesve: 21,8948,420 kg fruta perime të eksportuara në vitin 2020 sipas INSTAT x 3 lekë/kg	- 656.8 mil lekë/vit - 5.34 mil euro/vit
3	Efekti pozitiv i propozimeve 1 dhe 3 është formalizimi (fermeri kërkon faturë për të marrë stimulim dhe tregtari jep faturë se krediton TVSH), pra rritja e të ardhurave në buxhetin e shtetit. Sektori i bujqësisë, për shkak të shkallës së TVSH 0 në blerje dhe 20 në shitje është minimalisht 70-90% informal. Produkti bujqësor zë 20% të PBB, i cili në vitin 2022 parashikohet 15.2 miliard euro x 20% = 3.04 miliard euro x 70% informal = 2.1 miliardë euro PBB bujqësor informal! Në rastin më të keq në vitin e parë formalizohet 80% e 2.1. mil = 1.68 miliardë x 8.9% TVSH = 149,5 milion euro + 1.68 miliardë x 1.9% Tatim Fitim = 31.9 milion euro. Vetëm nga TVSH dhe Tatim Fitimi pa taksat e tjera që burojnënga ky formalizim buxheti perfiton 181.4 milion euro.	+ 22,312.2 mil lekë/vit + 181.4 mil euro/vit
4	Përfashtimi nga TVSH në import për makineritë dhe pajisjet e importuara në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë.	+ 200 mil lekë/vit + 1.62 mil euro/vit
5	Shfuqizimi i përfashtimit nga TVSH në import për importimin e makinerive prodhuese nga subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.	+ 200 mil lekë/vit + 1.62. mil euro/vit
6	Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor, nga 6% bëhet 0%.	+ 750 mil lekë/vit + 6.1 mil euro /vit
7	Të barazohet TVSH në blerje nga fermerët dhe në shitje në masën 20%. E llogaritur si 3.3 fishi i 6% kompesim të zeruar 750 mil lekë x 3.3= 2,475 milion lekë.	-2,475 mil lekë/vit -20 mil euro/vit
	Rezultati final në buxhetin e shtetit nga këto ndërhyrje fiskale dhe subvencionuese do të jetë minimalisht:	+ 11.580.9 mil lekë/vit + 94.4 mil euro/vit

SHOQATA E EKSPORTUESVE KËSHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR SINDIKATA E FERMERËVE

“Po godisni bujqësinë”! - Braçe, kundër paketës fiskale: Të barazohet skema e TVSH-së, të krijohet bursa

Deputeti socialist Erion Braçe është kategorikisht kundër paketës fiskale të hartuar nga qeveria për sektorin bujqësor, duke u shprehur se kjo është goditja e radhës për fermerët.

Braçe sugjeron barazimin e skemës së TVSH-së në blerje dhe në shitje për transaksione të brendshme nga fermerët tek grumbulluesit.

Nga ana tjetër, rekomandon edhe krijimin e bursës së bujqësisë në mënyrë që të mos abuzohet me çmimet në kurriz të fermerëve.

Deputeti socialist i cili ka drejtuar Komisionin Parlamentar të Ekonomisë për shumë vite, ka qenë i vetmi në radhët e mazhorancës që ka kritikuar ndryshimet fiskale për sektorin bujqësor.

KËRKESAT E ORGANIZATAVE DHE ARGUMENTET PËRKATËSE

1-) Subvencionim direkt për fermerët që kultivojnë perime të freskëta në bazë të produktit të hedhur në treg, të justifikuar me faturë tatimore, e ngjashme me skemën e aplikuar në vitin 2019, për prodhuesit e qumështit, por pa procedurat burokratike të aplikimit dhe konkurimit në AZHBR dhe pa limit. Në vlerësojmë propozimin për ndryshimin e formës së subvencionimit të fermerëve duke zëvendësuar këtë subvencionim indirekt apo kompesimin që deri më tani tregtarët dhe agropërpunuesit ua kanë dhënë fermerëve në blerje në masën 6% mbi çmimin e tregut. E vlerësojmë sepse kjo ka qenë një barrë financiare për tregtarët dhe agropërpunuesit, të cilët duhet të kreditonin fermerët nga fondet e tyre për një periudhë kohe që shkonte nga tre muaj deri në një vit, që t'ia merrnin konsumatorit kur shisnin brenda vendit ose të merrnin rimbursimin kur eksportonin.

Disa nga benefitet e kësaj skeme do të ishin:

a-)Do të formalizonte qarkullimin e brenshëm të produkteve bujqësore e blektorale dhe do të rriste të ardhurat në buxhetin e shtetit sepse në bazë ka faturën e shitjes që duhet të zotërojë fermeri i cili do të jetë i interesuar të mos hedhë në treg asnjëkilogram produkt pa faturë.

b-) Duke mundësuar gjurmueshmërinë do të stimulonte fermerin që prodhon produkt me standardet e tregut, që do të thotë se subvencioni nuk nxit parazitizëm por promovon suksesin, standardin dhe cilësinë e lartë.

c-) Do të shmangte subjektivitetin dhe korrupsionin e administratës shtetërore sepse i vetmi dokument për t'u verifikuar është fatura tatimore, të cilën e monitoron dhe administron administrata tatimore.

d-) Në mungesë të regjistrimit të fermave, kjo skemë do të shmangte burokracinë dhe dokumentacionin e vështirë për t'u siguruar nga fermeri sepse pjesa më e madhe nuk e ka juridikisht titullin e pronësisë.

e-) Do të kursente apo zeronte shpenzimet infrastrukturore për zbatimin e skemës (rasti i naftës pa akcizë ku janë shpenzuar fonde të konsiderueshme për hartimin dhe monitorimin e skemës).

2-)Stimulim të eksportuesve nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (sipas modeleve të rajonit) për çdo eksport të realizuar sepse eksportuesit janë promotorë të zhvillimit të bujqësisë dhe partnerët më të dobishëm të fermerëve. Ata kryejnë biznes me risk të lartë, pasi grumbullojnë perime me çmim blerje të paravendosur ndërkohë që tregu pëson luhatje të forta brenda ditës dhe shpesh godet tregtarët me ulje të çmimeve të shitjes. Me risk të lartë sepse eksportuesit paguajnë pasojat që vijnë nga kontrollat për pesticide në vendet ku eksportohet. Eksportuesit paguajnë përmes kreditnotave edhe për dëmtimet gjatë procesit të transportit, për shkak të difekteve në kultivim dhe difekteve në farëra e impute.

3-)Barazim në paketën fiskale 2022 të shkallës së TVSH në shitje me atë në blerje për sektorin e tregtimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore e blektorale, sepse aplikimi i shkallëve të ndryshme të TVSH që në paketën fiskale të paraqitur nga Qeveria parashikohet në mënyrë paradoksale të jetë 0% në blerje dhe 20% në shitje thellon informalitetin dhe dëmton fermerët, tregtarët dhe agropërpunuesit. Kjo do t'i vërë operatorët e këtij sektori në një regjim taksimi të padrejtë dhe për pasojë i detyron të furnizohen me produkte bujqësore nga importi dhe të braktisin produktin vendas.

Zbatimi i kësaj kërkesë për ne është një detyrim ligjor për qeverinë, sepse aktualisht kjo skemë shtrembëron frymën e ligjit për TVSH dhe prish mekanizmin e vjeljes të këtij tatimi, pasi tregtarët apo agropërpunuesit, me ndryshimin e fundit, nuk paguajnë më TVSH por një tatim mbi qarkullimin. Kur u bë 20% kompesimi në vitin 2014, u rregullua në mënyrë të pavullnetshme ky handicap sepse qëllimi ishte realizimi i kompesimit për fermerin jo rregullimi i mekanizmit të vjeljes së TVSH në përputhje me frymën e ligjit. Si rezultat i rregullimit të këtij mekanizmi dhe kthimit në parimin e proporcionalitetit të këtij tatimi, në sektorin e bujqësisë u rrit kërkesa për produktin bujqësor vendas e për pasojë e efektit të mekanizmave të tregut (raporti ofertë / kërkesë), u rrit çmimi i shitjes dhe u rrit formalizimi i sektorit.

Ne jemi të bindur se zbatimi i kësaj kërkesë do të formalizonte qarkullimin e brendshëm të produkteve bujqësore që aktualisht është 70-90% informal dhe për pasojë do të rriste të ardhurat në buxhetin e shtetit në një masë relativisht të barabartë me subvencionin që ne kërkojmë në kërkesën nr.1 dhe rimbursimin që do të përfitojnë eksportuesit.

Duke qenë se rreth 90% të produktit që eksportohet blihet nga prodhuesit bujqësor me statusin "Fermer" nëpërmjet autofaturës, kërkojmë të njihet e drejta legjitime që në autofaturë të llogaritet TVSH në blerje në shkallën e përcaktuar aktualisht në ligj për këto produkte dhe kjo TVSH e llogaritur të njihet e kreditueshme. TVSH të llogaritet si 1/6 e çmimit fundor të blerjes, ndërkohë që shkalla e TVSH për këto produkte në shitje është 20%. Pra të barazohet shkalla e TVSH në shitje me atë në blerje.

E kërkojmë dhe e konsiderojmë këtë si një të drejtë legjitime për të gjithë operatorët ekonomikë të këtij sektori (eksportues, agropërpunues, distributorë në tregun e brenshëm etj.) sepse nuk mund të konkurojmë në tregun rajonal dhe atë europian. Këtë të drejtë na e jep ligji në fuqi dhe jo më kot është përcaktuar shkalla e TVSH 0 (zero) në eksport, jo vetëm në vendin tonë, por në të gjithë botën, sepse është një incentivë për të nxitur dhe mbështetur eksportet.

Nëse pretendohet se eksportuesit dhe agropërpunuesit tek fermerët blejnë me çmim pa TVSH është e gabuar, e pavërtetë dhe e padrejtë. Vendi ynë ka një specifikë që në çdo hallkë të tregut negociohet çmimi fundor me TVSH, përfshirë këtu edhe tregun e fruta perime.

a-) Në blejmë me të njëjtin çmim fundor të cilin e vendos tregu me mekanizmin e raportit kërkesë/ofertë, si te fermeri ashtu dhe tek fermat e organizuara që janë subjekt i TVSH. Ndërkohë që kur blejme tek këto të fundit në kreditojmë TVSH e pasqyruar në faturë, kur

blejmë tek fermeri po me të njëjtin çmim fundor ne nuk llogarisim dhe kreditojmë TVSH.

b-) Nuk duhet harruar që çmimi që blejmë tek fermeri ka të inkorporuar në koston e mallit edhe TVSH që fermeri ka paguar:

-Kur ka blerë me TVSH të gjitha materialet për ndërtimin e serrës dhe investime të tjera për sistemet e ujitjes dhe shpenzime të tjera.

-Kur ka blerë fillimisht dhe sa herë që ndërron plastmasin.

-Kur blen energjinë elektrike.

-Kur blen naftën në rastin kur nuk përfiton nga skema aktuale se është pronar me më pak se 0.4 ha tokë.

- Kur blen shërbime mirëmbajtje për mekanikën bujqësore.

- Kur do blejë imputet bujqësore me 10% TVSH, etj.

Këtë TVSH që paguan fermeri në blerje, shteti ia vjel operatorit shitës tek fermeri, ndërsa paradoksalisht, operatorëve që blejnë tek fermeri kjo nuk i llogaritet dhe nuk i kreditohet, në mënyrë të kundraligjshme, edhe pse kjo TVSH paguhet e inkorporuar në çmimin e shitjes si kosto produkti.

Fakti që qeveria nuk i vjel TVSH në shitje fermerit për diskriminim pozitiv dhe shumë mirë bën, nuk do të thotë që këtë TVSH nuk e paguan blerësi. Në rastin kur tregtarët dhe agropërpunuesit shesin në tregun vendas, këtë TVSH shteti e vjel dy herë; një herë ia vjel operatorit që shet tek fermeri dhe për së dyti operatorëve që blejnë tek fermeri dhe shesin në rrjetin tregtar pa llogaritur të zbritshme TVSH e paguar në blerje. Kjo është e paligjshme, e padrejtë dhe shkon deri në faj.

" Ligji Nr. 92/2014 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" Neni 1 Objekti i ligjit 1. Ky ligj vendos tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH-në). 2. TVSH-ja është një tatim i përgjithshëm mbi konsumin e mallrave dhe shërbimeve, proporcional me çmimin e tyre, që i ngarkohet në çdo fazë të prodhimit dhe procesit të shpërndarjes çmimit pa tatimin. TVSH-ja zbatohet si një tatim në përqindje mbi çmimin e mallrave dhe shërbimeve dhe bëhet e kërkueshme për t'u paguar pas zbritjes së TVSH-së që rëndon drejtpërdrejt elementet e koston së mallrave dhe të shërbimeve."

Për këtë arsye tregu i brenshëm i fruta-perimeve është aktualisht 90% informal dhe shteti nuk vjel TVSH që konsumatori e paguan. Edhe ne si eksportues dhe agropërpunues e kemi të nevojshme të dalim në tregun vendas, qoftë me produktet që kanë standard eksporti, por edhe me produkte më pak cilësore që mund të përdoren në industrinë përpunuese, por që në këto kushte e kemi të pamundur, pasi na intereson më mirë ta asgjësojmë për shkak të tatimit që do paguanim.

4-) Nisur nga fakti që këtë periudhë ka ngritje të çmimeve të imputeve bujqësore në masën 30-100% për shkak të krizës globale energjetike, kërkojmë shtyrjen në kohë të aplikimi të TVSH në shkallën 10% si kundër është paraqitur në projekt paketën fiskale për vitin 2022.

5-)Mbështesim krijimin në MBZHR të një zyre apo agjensie për studimin e tregjeve dhe orientimin e fermerëve, në bashkëpunim me shërbimin e ekstensionit dhe specialistët e Drejtorive Rajonale të Bujqësisë. Kërkojmë garantim dhe monitorim të cilësisë së imputeve bujqësore dhe në këtë drejtim mbështesim hapat e marrë për ristrukturimin dhe rishikimin e bazës ligjore, që rregullon veprimtarinë e AKU, si dhe ngritjen e Urdhërit të Agronomit dhe aplikimin e librit të fermës ndjekjes së protokolleve në funksion të kontrollit të prodhimit në të gjitha fazat. Gjithashtu mbështesim fuqishëm investimet e reja për kontrollin dhe monitorimin e cilësisë së produkteve tona nëpërmjet laboratorëve të akredituar dhe heqjen e Listës B të pesticideve.

Mbështesim krijimin e një agjensie në MBZHR, të ndihmuar edhe nga diplomacia ekonomike, që të studjojë tregun e brendshëm e të jashtëm të produkteve bujqësore, duke evidentuar asortimentet dhe sasitë që absorbojnë këto tregje në periudha të caktuara të vitit dhe në bazë të këtyre të dhënave të bëjë një orientim makro për fermerët shqiptarë për çfarë dhe sa duhet të mbjellin. Kështu zbuten ose shmangen krizat e forta të tregut. Ky lloj shërbimi do të ndihmonte eksportuesit dhe fermerët për të qenë më të orientuar për vendimarrjen e tyre në përzgjedhjen e kulturës, varietetit, afateve kohore, teknologjisë së aplikuar etj. Si model të shërbimit të ekstensionit propozojmë modelet e Italisë apo Greqisë ku çdo agronom ka të kontraktuar një numër fermerësh që mbikëqyr dhe për të cilët mban përgjegjësi deri te firmosja e certifikatës fitosanitare që tek ne e firmos qorrazi një agronom që nuk ka lidhje me fermerët, por që thirret nga grumbulluesi para nisjes së trajlerit për eksport.

Kemi mbi 20 vite që fermerët plehërojnë tokën pa ditur çfarë ka toka, por duke ditur vetëm çfarë do bima. Blejnë impute pa asnjë garanci që përbërja e tyre në elemente përputhet me etiketën. Fermerët prodhues janë etiketuar të gjithë si kriminelë dhe kjo ka ulur në masë të madhe konsumin e produkteve tona sepse nuk ka një laborator të certifikuar që të distancojë një minorancë që abuzon me pesticidet, nga mazhoranca që punon me ndershmëri dhe korrektësi.Kjo do të garantonte sigurinë ushqimore dhe do të rriste besimin e konsumatorit e për pasojë do të rritet kërkesa në treg për produktet tona.

6-)Kërkojmë nga qeveria të angazhohet në rregullimin me ligj të kushteve dhe mënyrën e kryerjes së tregtisë me produktet bujqësore për të garantuar interesat e paleve në këtë treg. Aktualisht fermerët janë të pambrojtur në treg në aspektin e likuidimit të faturave të tyre nga grumbulluesit. Në këtë aspekt kërkojmë zbatimin e modelit të Maqedonisë së Veriut, ku grumbulluesit dhe tregtarët e fruta-perimeve regjistrohen edhe në Ministrinë e Bujqësisë dhe përveç standardeve të tjera mbyllin dhe një fond garancie, i cili garanton likuidimin e faturave të fermerëve brenda një afati 60 ditor të përcaktuar në ligj.

Qendra ABA është zëri i fermerëve shqiptarë!

Qendra ABA (Agro Biznes Asistencë) u krijua me iniciativën dhe mbështetjen e FED invest dhe të Projektit "Përfshirja financiare e fermave familjare në Shqipëri" financuar nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar - JICA.

Objektivi i Qendrës ABA është përmbyllja e nevojave të çdo fermeri shqiptar, me qëllim zhvillimin e tyre të biznesit dhe ndërtimin e kapaciteteve dhe aftësive financiare. Kërkesat për ngritjen e qendrës së fermerëve janë rritur bashkë me suksesin e FED invest dhe anëtarësisë. Me qëllim ofrimit të shërbimeve tek çdo fermer shqiptar, kjo qendër ka zhvilluar platformën digjitale ABA Online.

Çfarë ofron Qendra ABA?

Qendra ABA ofron informacion, ekspertizë, edukim dhe mundësinë për krijimin e lidhjeve të biznesit, si dhe rritjen e kapaciteteve të biznesit për të gjithë fermerët shqiptarë.

Në Qendrën ABA fermerët do të gjejnë:

- Njohuri teknike dhe praktike në fushën e bujqësisë & blegtorisë përmes trajnimeve dhe demonstrimeve praktike në terren;
- Informacione mbi teknologjitë e prodhimit, inputet bujqësore, certifikimet bujqë-

sore, standardet për eksport, në bibliotekën e Qendrës ABA;

- Aktivitete për njohjen e aktorëve të zinxhirit të vlerave dhe bizneseve bujqësore ku mund ndahen njohuri dhe përvoja me fermerë të tjerë;
- Seminare dhe trajnime në çdo fazë të rritjes së biznesit.

Po përpiqeni të gjeni një informacion objektiv, i cili plotëson nevojat tuaja të veçanta të biznesit? Klikoni tani në faqen tonë www.abaonline.al për të mos humbur zhvillimet më të fundit në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë në vend.

Çfarë është platforma ABA Online?

ABA online është një platformë digjitale që ofron informacione dhe shërbime në sektorin e bujqësisë për të përmbyllur nevojat e çdo fermeri shqiptar me qëllim zhvillimin e tyre të biznesit dhe aftësive financiare.

Të gjitha aktivitetet dhe shërbimet në Qendrën ABA janë dizenuar me qëllim zhvillimin e aktiviteteve bujqësore dhe blegtoriale të fermerëve dhe reflektohen në kohë reale në ABA online për të arritur çdo fermer në mbarë vendin. Në ABA online fermerët mund të marrin:

- Informacione mbi teknologjitë e prodhimit, lëndët e para, plehrat kimike dhe organike, pesticidet, çmimet e tregut, standardet për eksport dhe cer-

tifikimet bujqësore, skemat e subvencionit etj;

- Tregu Online: mundësi tregtimi dhe marketimi të produkteve bujqësore dhe blegtoriale, pa asnjë kosto shtesë;
- Pyet Ekspertin: këshilla teknike agronomike & blegtoriale të personalizuar nga ekspertë të fushës;

• Edukim financiar si dhe promovimin e praktikave më të mira në bujqësi e blegtori;

- Krijimin e kontakteve dhe partneriteteve midis fermerëve, tregut dhe partnerëve të Zinxhirit të Vlerës për tregun bujqësor e blegtoral;

• Prezantimin e historive të suksesit të fermerëve dhe fermave bujqësore.

Çfarë duhet të bëni si pjesëmarrës në këtë konkurs?

- Mund të bëheni pjesë e këtij konkursi vetëm nëse jeni të regjistruar në ABA Online përmes një llogarie personale.

• Kujdesuni që të dhënat tuaja (emri, mbiemri, lloji i aktivitetit tuaj, email, nr. telefoni) të jenë të plotësuara saktë.

• Kujdesuni që personat e referuar prej jush, të plotësojnë saktë fushën "Referuar nga" gjatë regjistrimit, me emrin tuaj. Është e vetmja mënyrë që ju të merrni pikët e merituar. (Për t'u njohur me çmimet për fituesit, vizitoni ABA Online).

Shqipëri-Kosovë, rritje eksporteve bujqësore duke eliminuar çdo hallkë burokracie

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca priti në një takim ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës, Faton Peci.

Ministria Krifca bëri të ditur se gjatë takimit u diskutua mbi prioritetet e përbashkëta për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë në vendet tona.

"Folëm për hapa konkretë se si të nxisim më shumë shkëmbim tregtar bujqësor, më shumë eksport, duke eliminuar çdo hallkë burokracie të panevojshme. U zotuat për forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar me qëllim për të siguruar më shumë ekonomi për komunitetet rurale dhe për të fuqizuar avantazhet konkurruese të vendeve tona", tha ministria Krifca. Ministria e njohu homologun e saj nga Ko-

sova lidhur me Programin IPARD.

Ministri i Kosovës, Peci gjatë takimit foli për mundësinë e zbatimit të programit IPARD

Tiranë ministri Peci i shoqëruar nga ministria Krifca vizituan në Savër të Lushnjes, punën e tre agropërpunuesve përfutues, Ejupit,



edhe në Kosovë.

Në kuadër të vizitës zyrtare në

Netës dhe Lulos që bashkëpunojnë zinxhir me mijëra fermerë.

Nga ndërtimi në bujqësi - Fermeri që la pallatet për të mbjellë arra

Lulëzim Bullari, jeton në Cërrik të Elbasanit. Dikur ai ishte ndërtues, por prej 6 vitesh ai nuk ndërton më pallate por mbjellë arra

Në sipërfaqe prej 75 Ha ai ka mbjellë 25000 arra. Edhe pse arrat konsiderohen moshë e re, sasia e arrave që kanë prodhuar pemët e reja është e kënaqshme.

"Nga ndërtimi u hodha në bujqësi. Në këtë zonë ecin shumë mirë pemët si arra, bajamet, kivi. Në këtë zonë kam mbjellë 25.000 rrënjë arra, vjet mora 15 ton, ndërsa këtë vit pretendoj të marr 30 ton arra." tha fermeri Lulëzim Bullari.

Ish-ndërtuesi thotë se të hedhesh beton diku sot është bërë shumë stresuese, ndërsa të jesh fermer mer dashuri nga puna jote në çdo ditë të vitit.

"Përse le ndërtimin për tu



marrë me bujqësinë? Puna me njerëzit më lodhi, plus që ndërtimi ra kështu vendosa të

merresha me natyrë. Më shumë të ardhura të siguron ndërtimi apo bujqësia? Me bujqësinë jam shumë i kënaqur", tha ai.

Të kultivosh arra do të thotë se i ke siguruar vetës një jetesë të mirë. Një kilogram arra kurrë nuk shitet më pak se 500 Lekë kilogrami.

"Konsumi shqiptar është shumë i uritur për frutat e thata si arra dhe bajame. Nga jashtë importohen rreth 600-700 ton arra, ndërkohë që unë më këtë sipërfaqe mendoj se plotësoj afërsisht 30% të kërkesave të tregut. Çmimi dhe tregu është i lehtë për tu gjetur, një kilogram arra shitet 500 lekë të reja", tha fermeri.

Gratë në biznes, sfida për fuqizimin e tyre

Njohja me sfidat aktuale të grave në biznes dhe disa propozime për fuqizimin e tyre ishin në qendër të takimit të disa prej drejtuesve të Dhomës Ekonomike të Gruas dhe Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Edona Bilali.

Kryetarja e Dhomës Antonela Hako, theksoi gjatë takimit se gratë sipërmarrëse kanë nevojë për më shumë kohë tranzitore në procesin e fiskalizimit dhe për mundësi më të lehta financimi. Përfaqë-



sueset e Dhomës i dorëzuan ministres një dokument me 8 kërkesa, duke shprehur gatishmërinë për të qenë pjesë e diskutimeve konstruktive në dobi të sipërmarrjes.

Ministria u tregua e gatshme të jetë krah grave sipërmarrëse, me advokimin dhe ndërmjetësimin me institucionet e tjera publike.

Gjatë Nëntorit, në javën e sipërmarrjes, do t'u dedikohet një ditë e hapur në Ministri pikërisht sipërmarrjeve të drejtuara nga gra.

Financim startup-ve në shërbim të bujqësisë

Mbështetja për inovacionin dhe digjitalizimin duke financuar të rinjtë të zhvillojnë startup-e në shërbim të bujqësisë së zhvilluar, zë një vend të rëndësishëm në buxhetin e vitit 2022.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bën të ditur se, mbi 400 milionë lekë është buxheti i vitit 2022, që adreson financim për startup-e në shërbim të bujqësisë dhe projektet e të rinjve që i afrohen bujqësisë.

Gjithashtu, njofton MB-ZHR, 200 milionë lekë është bashkëfinancimi i qeverisë shqiptare dhe KfW për dhënie e granteve për startup-et në bujqësi dhe peshkim, ku 50 % është financim nga investimi privat dhe 50 % nga granti.

Ndërkohë, fondi i garancisë prej 5 milionë euro, siguron 50 % të mbulimit të kreditit për projektet inovative në bujqësi ku pritet të përfitojnë 500 deri 1000 fermerë në të gjithë vendin.

Regjistrimi në ABA Online ju ofron:

- Çmimet e tregut
- Mundësi tregtimi online
- Këshillim mbi teknologjitë e prodhimit & Kalendarin e fermës
- Edukim Financiar
- Parashikimi i javor i motit

"Postova shalqirin në tregun ABA online dhe realizova shitje brenda 4 ditëve me një tregtar nga Kosova."

Redi Fermer, Vlorë

Shkarko aplikacionin ABA Online në:

Google play | App Store

abaonline.al | Qendra ABA | Qendra_ABA

JICA

Mbështetje nga JICA, Shqipëria krijon hartat digjitale topografike

Shqipëria ka krijuar për herë të parë hartat digjitale topografike të standardeve bashkëkohore, që i vijnë në mbështetje zhvillimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të sektorëve ekonomiko-socialë të vendit.

Që nga viti 2017, qeveria shqiptare në bashkëpunim me qeverinë e Japonisë, përmes Agjencisë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (JICA), mbështesin Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), për të zbatuar "Projektin për Informacionin Gjeohapësinor dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Tokës në Zonën Tiranë-Durrës".

Objektivi kryesor i projektit është rritja e aktiviteteve të zhvillimit social dhe ekonomik në këtë zonë, duke shfrytëzuar hartat topografike digjitale në shkallë të gjerë. Projekti gjithashtu ka zhvilluar me sukses kapacitetin e prodhimit të hartave topografike dhe saktësinë e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG).

Hartat topografike digjitale të shkallës 1:2000 që mbulojnë 300 km² u krijuan nga një bashkëpunim i suksesshëm midis Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor (ASIG) dhe Ekipit të Projektit JICA që përfshin kompanitë lokale. Hartat janë në përputhje me direktivën BE INSPIRE dhe kanë rezolucion të saktësi të lartë.

Konferenca përmbyllëse e Projektit si dhe Konferenca Rajonale Ballkanike u mbajtën më 4 nëntor dhe 5 nëntor, për të ndarë rezultatet e arritura me palët e interesuara, agjencitë qeveritare, bashkitë, ambasadat e Japonisë në rajonin e Ballkanit, kompanitë lokale, etj., të cilët janë përdorues të mundshëm të hartave topografike digjitale të krijuara.

Ceremonia u zhvillua në selinë e ASIG-ut në Tiranë, ku morën pjesë Ambasadori i Japonisë në Shqipëri Takada Mitsuyuki, përfaqësuesi Kryesor i Zyrës Ballkanike të JICA, Takeichi Jiro, Drejtori i Përgjithshëm i ASIG Lorenc



Çala si dhe aktorë të tjerë të interesuar.

"Kemi kurorëzuar me sukses

në punën e tyre të përditshme, duke u dhënë atyre vlerë dhe lehtësim të proceseve që lidhen



zhvillim".

"Projekti i zbatuar në Shqipëri me ASIG, është i fundit

ofrimit të shërbimeve publike. Vështirësia qëndron në marrjen dhe zotërimin e këtyre



një projekt të rëndësishëm asistence teknike që Japonia ka zbatuar në Shqipëri në tre vitet e fundit. Jemi mbledhur sot për të ndarë së bashku me ju arritjet e kësaj sipërmarrjeje të rëndësishme, duke shpresuar shumë që ekspertiza dhe njohuritë e përfituara nga ky projekt si dhe produkti kryesor i tij, hartat topografike digjitale, do të ndihmojnë autoritetet shqiptare

me planifikimin urban si dhe zhvillimin social dhe ekonomik të vendit", tha ambasadori i Japonisë në Shqipëri, Takada Mitsuyuki.

Ai theksoi: "Japonia ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të promovuar ndërtimin e infrastrukturës cilësore jashtë vendit për zhvillim të qëndrueshëm, krah për krah me partnerët vendas në vendet në



i një gjerdani të çmuar me ekspertizë të çmuar që Japonia ka kontribuar në zhvillimin e Ballkanit Perëndimor. Unë jam veçanërisht i lumtur sot për të konstatuar këtë fakt", deklaroi ambasadori.

Ndërsa vuri në dukje: "Sot jetojmë në epokën e teknologjisë së avancuar, e cila ka ndryshuar rrënjësisht mënyrën e menaxhimit dhe

teknologjive. Kjo është bërë e mundur nga JICA dhe Japonia dhe do të jemi shumë të lumtur të shohim që këto harta përdoren për të sjellë zhvillim në çdo cep të Shqipërisë, si dhe në rajonin e Ballkanit".

Ndërsa drejtori Çala tha se rreth 80 % e vendimmarrjes së Qeverisjes Qendrore dhe Vendore ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në territor dhe pasja e

hartave topografike digjitale tanimë ndihmon jashtëzakonisht shumë në veprimtaritë planifikuese, zhvilluese dhe monitoruese të shumë institucioneve në Shqipëri.

Ai tha se, hartat digjitale janë krijuar me mbështetjen e projektit JICA-n, i cili ka zhvilluar në Japoni, trajnime afatgjata dhe afatshkurtra për një pjesë të mirë të personelit të ASIG-ut, lidhur me teknologji të përparuara për mbledhjen e të dhënave, përditësimin dhe shfrytëzimin sa më të mirë të informacionit gjeohapësinor.

Të dyja konferencat nisën me fjalën hapëse të Ambasadorit të Japonisë në Shqipëri, Takada dhe drejtorit të përgjithshëm të ASIG, Lorenc Çala. Një ekspert nga Autoriteti i Informacionit Gjeohapësinor të Japonisë prezantoi një teknologji të re të quajtur "GSI Vector Map" e ndjekur nga ekspertë të tjerë japonezë të cilët prezantuan rastet e përdorimit të hartave digjitale topografike nga komunat në Japoni. ASIG prezantoi Gjeoportalin Kombëtar dhe mënyrën e sigurimit të të dhënave të krijuara nga ky projekt përmes gjeoportalit.

Gjatë Konferencës Rajonale për Informacionin Gjeohapësinor, rezultatet e projektit iu prezantuan përfaqësuesve të agjencive kombëtare të informacionit gjeohapësinor të Rajonit të Ballkanit Perëndimor, të cilët në të njëjtën kohë prezantuan planet e tyre të ardhshme dhe pritjet për asistencë teknike nga JICA.

JICA është Agjencia e Qeverisë së Japonisë, përgjegjëse për zbatimin e ndihmës dypalëshe nëpërmjet Bashkëpunimit Teknik, Huave ODA (të buta) dhe Ndihmës Grant. Deri më tani në Republikën e Shqipërisë, JICA ka shtrirë projekte të ndryshme në fushën e mjedisit, zhvillimit të sektorit privat dhe promovimit të shëndetësisë dhe turizmit.

Zyra e Ballkanit e JICA-s mbulon aktivitetet në 6 shtete në Ballkan: Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.





TASE GROUP

Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra Kondor (ish parku i autobuzave, poshtë "21 Dhjetorit"), Tiranë
Tel: 0035542239968; Fax/Tel: 0035542220027; e-mail: info@tasegroup.al;
Website: www.tasegroup.al; Celular: 0684855580 (Kushineta, Premistopa dhe rripa)
Celular: 0672035581 (Pjesë këmbimi për traktorë)



Ofrojmë:

- PJESE MOTORIKE
- FREKSIONE
- PERMISTOPA
- KUSHINETA
- RRIPIA
- AKSE
- PJESE ELEKTRIKE
- PJESE HIDRAULIKE
- VAJRA DHE FILTRA



KASH

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në
7 MILIONË
Lekë



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

“Integrimi në BE dhe mbështetja e politikave në bujqësi dhe zhvillim rural”, financuar nga FAO është projekti që nisin mbështetje të Shqipërisë për përmirësimin dhe gjithëpërfshirjen e politikave bujqësore për fermat familjare, nxitjen e zhvillimit rural, mirëqenien e popullsisë rurale dhe ruajtjen e trashëgimisë shqiptare. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca dhe Përfaqësuesi i FAO për Shqipërinë, Raimund Jehle, vlerësuan nisjen e projektit si një nga rekomandimet e Raport Progresit për Kapitullin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca theksoi se orientimi i bujqësisë shqiptare është qartësisht i mirëpërcaktuar nga ambicia e qeverisë për të bërë anëtarët Bashkimit Evropian. Dhe në këtë kontekst, parakushtetë përcaktuara nga acquis communautaire, të cilat kanë të bëjnë me përafrimin e legjislacionit dhe kuadrin rregullativ për krijimin e mjedisit të duhur, sidhe mirë funksionimin e politikës së përbashkët Europiane kthehen në busulla orientimi për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

“Një pjesë e rëndësishme e rekomandimeve të përcaktuara qartë në raportet e progresit të

FAO dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nisin bashkëpunimin teknik për zbatimin e projektit mbi Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit të Fermës

BE, kthehen për Ministrinë e

ekonomisë e fermave, për një politikëbërje në vijim shumë



regjistri i fermës për tu kryer brenda vitit 2021, kuadrilgjor për bujqësinë organike, për politikën e cilësisë, ligji për verën, dhe rekomandimet e tjera në lidhje me Kapitullin 11 të Raport Progresit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Specifikisht do të fillojë puna për një tjetër rekomandim të BE, “Hartimi i politikës së zbatimit për Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit të Fermës (FADN)”, e rëndësishme për

herë më të mirë, në drejtimin e Ministrisë së Bujqësisë”, tha ministria Frida Krifca.

Duke falenderuar FAO për angazhimin dhe bashkëpunimin në mbështetje të kësaj kërkesë të Bashkimit Evropian, ministria Krifca shpehu angazhimin e saj për bashkëpunimin e axhendës së bashkëpunimit teknik me FAO, për dakordësimin dhe rëndësinë e domosdoshme të mbajtjes së të dhënave të fermës.

Përfaqësuesi i FAO për Shqipërinë, Raimund Jehle vlerësoi përpjekjet e Shqipërisë në kuadër të anëtarësimit me BE dhe integrimin e sektorit

mirë, por në të njëjtën kohë siguron mbështetjen e vendeve tona anëtare në këtë përpjekje, dhe Shqipërinë si vend anëtar i FAO-s”, theksoi Jehle. Ai



të bujqësisë, peshkimit dhe pylltarisë, dhe në këtë kontekst shprehu gatishmërinë e FAO-s në mbështetje të Qeverisë Shqiptare për ofrimin e ekspertizës përkatëse të kërkuar.

“Korniza e re Strategjike e FAO-s, 2022 – 2031, nënvizon qasjen për një prodhim më të mirë, ushqim më të mirë, mjedis më të mirë dhe jetë më të

shtoi se Dialogu kombëtar për sistemet ushqimore, qasja në fillim të këtij viti dhe rrugët e zhvilluara tregojnë potencialin e sektorit agro-ushqimor, por edhe sfidat që duhen përballur në këtë kontekst.

Gjatë fjalës së tij Jehle, u ndal tek marrëveshja midis organizatave të Kombeve të Bashkuara që punojnë në Shq-

ipëri dhe Qeverisë Shqiptare për Kornizën e re të Bashkëpunimit të OKB-së me Shqipërinë, ku një nga rezultatet kryesore e kësaj marrëveshje është rritja e qëndrueshme dhe zhvillimi i gjelbër. “Sektori agroushqimor është një pjesë kyçe e kësaj kornize në mbështetje të kësaj përpjekje, e cilën në të njëjtën mënyrë kontribuon në arritjen e marrëveshjes së gjelbër, strategjisë nga “Ferma në tavolinë”, dhe strategjisë për biodiversitetin nga Bashkimi Evropian” shtoi Raimund Jehle, Përfaqësuesi i FAO për Shqipërinë.

Projekti do t'i mundësojë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të arrijë etapa të reja si: krijimi i një procesi të fortë vendimmarrjeje të bazuar në të dhënat e fermave (sistemi FADN), përmirësimin në kuadrin ligjor në përafrim me rregullat e BE-së për politikën e cilësisë dhe bujqësinë organike, adresimi i standardeve të marketingut dhe monitorimi i politikave me vlerësimin e programit, shqyrtimi i mënyrës së mbështetjes institucionale për promovimin dhe eksporte të produkteve bujqësore, përmirësimin e shërbimit këshillimor për fermerët, ngritja e një sistemi operacional të informacionit për çmimet, adresimi i impaktit të ndryshimeve klimatike tek fermerët dhe prodhuesit e vegjël.

Intervista e plotë e përfaqësuesit të FAO për Shqipërinë, Raimund Jehle

Përshëndetje z. Jehle! Mirëse keni ardhur në Shqipëri dhe faleminderit që pranuat këtë intervistë.

Dua ta nis intervistën tonë me një fenomen që ka prekur të gjithë botën, Covid-19. Si ka ndikuar pandeminë Europë dhe a keni ju një informacion lidhur me ndikimin e saj në ushqim?

Faleminderit për ftesën, është kënaqësi. Lidhur me pandeminë Covid 19, dua të theksoj se për momentin nuk ka ndonjë dokument shkencor që analizon ndikimin tek produktet bujqësore, osembi impaktin tek lehtësuesit dhe transportuesit pasojë e SARS Covid 2.

Por sigurisht, pandemia Covid-19ka patur implikime të forta sa i përket sektorit agroushqimor, veçanërisht në fillim. Duke patur parasysh situatën e izolimit, masat parandaluese, vështirësia e mundësisë mallrave në treg. Gjithashtu, për shkak të mbylljes, ka patur ndikime edhe në sektorin e turizmit, ku janë prekur restorantet hoteleve, si dhe dhe shërbimi i kateringut. Në disa pjesë të Europës, prodhimi ifrutave dhe perimevekapësuar goditje, për shkak të mungesës së fuqisë punëtore.

Ndërsa, në këndvështrimin e sigurisë ushqimore nuk ka implikime specifike që mund të ketë ndikuar virusi SARS Covid 2. Dua të theksoj se konsumatorët nuk duhet të ndihen të frikësuar dhe të pasigurt

për konsumimin e produkteve bujqësore, për shkak se Covid -19 nuk mund të transmetohet me ushqimin që nekonsumojmë.

Vendi ynë është prekur edhe nga tërmeti, i cili ka shkaktuar dëme materiale në disa qytete të Shqipërisë. Gjatë qëndrimit tuaj, ju vizituat ndërtesat në terren, si ju duk gjendja?

Dua të përgëzoj Shqipërinë për përpjekjet që ka bërë deri tani sa i përket rikuperimit nga tërmeti. Kur vizitova tërmetin, zonat e rindërtuara, kishim mundësi të shihnim dëmet masive që kishin ndodhur, dhëmë vjen mirë që shumica e tyre ishte rindërtuar tashmë.

Në këtë kontekst, pashënë terren ringritjen nga tërmeti, dhe shpreh pozitivitet për sektorin bujqësisë. Sigurisht, tragjedia nga tërmeti ka shkaktuar shumë probleme të mëdha me shtëpitë, shkollat dhe infrastrukturën. Por edhe sektori bujqësor nuk duhet harruar dhe lënë mënjane. Fermerët e vegjël që unë takova, një grua fermere kishte humbur 39 dele dhe ferma blegtorale e saj ishte shkatërruar plotësisht si pasojë e tërmetit. Aktualisht është rindërtuar dhe ferma ishte në gjendje të mirë për të vazhduar aktivitetin, dhe pse jo për të zgjeruar më shumë.

Në çfarë niveli apo standardi është Shqipëria për sa i përket ekonomisë bujqësore? Po fermat bujqësore janë në standardin e duhur?

Projekti i ri në bashkëpunim

FAO mbështet Shqipërinë për integrimin në BE

me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që nis me Hartimin politikës së zbatimit për Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit të Fermës (FADN) tregon se sektori bujqësor në Shqipëri ka potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm. Shqipëria ka shënuar trend pozitiv në eksportet e frutave dhe perimeve, që është premtuese dhe e rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë. Nga ana tjetër, sigurisht që sektori ka një numër

mës, në mënyrë që të rrisin produktivitetin dhe është një nevojë për të ardhura shtesë, të cilat mund të gjenerojnë mundësi në sektorin bujqësor në të gjithë aspektet.

Nga ana tjetër, duhet të theksojmë edhe njëherëse bujqësia nuk është një sektor i vjetër. Bujqësia është një sektor modern, bujqësia përdor dixhitalizimin, bujqësia mund të jetë tërheqëse edhe për të rinjtë. Është një sektor me shumë variatete, dhe krijon mundësi për



Fiona McCluney, Koordinatorja e Përhershme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri Raimund Jehle, Përfaqësuesi i FAO-s për Shqipërinë

të madh sfidash, njënga këto është korniza institucionale, që kërkon mbështetje për finalizimin e kuadrit ligjor për verërat dhe bujqësinë organike. Në këtë aspekt, duhet të ketë përmirësim të mëtejshme, në mënyrë që Shqipëria të jetë gati dhe e aftë për anëtarësimin dhe përafrimin me BE-në.

Ne duhet të përmirësojmë kapacitetet prodhuese të fer-

tu angazhuar. Ne, FAO bashkë me qeverinë, synojmë ta bëjmë këtë sektor sa më tërheqës për të rinjtë, pasi bujqësia është sektori kyç për zhvillimin e ekonomisë në Shqipëri.

Le të ndalemi pak edhe të rritja e çmimeve e produkteve bujqësore. Pse ka ndikuar rritja dhe sa do zgjasë në nivel global?

Sigurisht, ka një rritje të

ndjeshme të çmimeve në 12 muajt e fundit, veçanërisht tek çmimi i grurit, për katër muajradhazi është rritur më shumë se 25 për qind. Kjo është shqetësuese dhe kemi parë se për shembull, çmimi i grurit në krahasim me situatën para Covid -19 është rritur tashmë me dy të tretat.

Por në të njëjtën kohë është e rëndësishme që duhet të rrisim transparencën në tregje. FAO ka instrumenta të nevojshme, si AMIS, që është Sistemi i Informacionit të Tregut Bujqësor, për tërëritur transparencën në tregje, dhe të investojmë në të dhëna. Kemi nevojë të mbledhim informacione të mëtejshme në mënyrë që të mundësojmë këtë transparencë, që çmimet e rritura të mos ndikohen nga spekulimet, por të jenë transparente.

Gjithashtu, një tjetër faktor që ka shkaktuar implikime të forta, është edhe rritja e çmimit të naftës dhe gazit prej disa muajsh, e cila ka ndikuar tek rritja e çmimeve.

Në këndvështrimin e konsumatorëve, prodhuesve dhe fermerëve, do të thoja se nuk është nevojë të jemi të frikësuar, pasi nuk shohim veçanti në rajon, që mund të ketë ndonjë pakësim të mallrave ushqimore. E rëndësishme është të investohet në transparencën e çmimeve dhe në mbledhjen e të dhënave.

Duke qenë se disa nga produktet shqiptare janë të

certifikuara dhe shkojnë në tregjet e vendeve të Bashkimit Evropian, a e ndihmon kjo Shqipërinë për të qenë pjesë e Europës?

Siç e përmenda edhe në aktivitetin e nisjes së bashkëpunimit teknik me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për projektin “Integrimi në BE dhe mbështetja e politikave në bujqësi dhe zhvillim rural”, financuar nga FAO, në këtë moment ka nevojë për përmirësimin e kornizës legjislative, e cila duhet të jetë në përputhje me Acquis Communautaire të BE.

Nëse e ndajmë në dy aspekte: në aspektin e prodhimit bimor dhe atë të prodhimit bimor të origjinës, mendoj se Shqipëria ka bërë përpjekje të mëdha. Siç e përmenda më parë eksportet janë në rritje dhe në këtë këndvështrim është premtuese, por sigurisht ka nevojë për përmirësim në kuadrin ligjor për verërat, për politikën e cilësisë dhe bujqësinë organike, në përputhje me standartet e BE-së.

Një tjetër aspekt, është çështja për produktet shtazore të origjinës, që është një situatë më komplekse për shkak të standardeve sanitare, ku prodhuesit duhet të ndjekin dhe të jenë në përputhje me standardet e BE-së. Këtu nuk është më çështja e standardeve që duhet të formulohen, por është çështja e sigurimit për cilësi adekuate dhe siguri sanitare nga ana e prodhuesve, dhe në këtë këndvështrim duhet bërë më shumë në Shqipëri.

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

Këshilla për fermerët që kultivojnë bimë aromatike mjekësore, nëntor 2021

Muaji nëntor është muaji në të cilin mund të realizohet mbjellja e shumë bimëve aromatike mjekësore (BAM) shumëvjeçare. Pasi kanë përfunduar të gjitha punimet përgatitore të tokës dhe plehërimet organike të saj, menjëherë duhet që të mbillen fidanat në vendin e tyre të përhërshëm, muaji Nëntor është i përshtatshëm dhe optimal për të realizuar këtë.

Për këto arësye duhet të merren këto masa:

- Fermeri të bëjë planin e punës për fuqinë punëtore që i nevojitet, mjetet e punës, materialet (fidan, marker, spango, lagsa për raste të nevojshme etj.)

- Të bëhet piketimi i parcelave, sipas distancave; bazuar dhe në numrin e bimëve për

ha që do përdoren. Rreshtat të jenë të drejtë dhe me një distancë larg njëri tjetrit në mënyrë që të lejoj punimet e mekanizuar (kultivim, korje).

- Nxjerrja dhe përgatitja e fidanave të bëhet në mënyrë të tillë që të kemi marrim një fidan sa më të shëndosh dhe të mirë. Për këtë arësye gjatë nxjerrjes fidani të tërhiqet me kujdes në mënyrë që mos keputet, dhe të terheqi me vete

sa më shumë rrënjë, por dhe mos të dëmtohen fidanët tjerë rreth tij

- Mbas nxjerrjes paktohet në tuba dhe menjëherë transportohet për në parcelen ku do mbillet përfundimisht.

- Në hyrje të parcelës, para mbjelljes bëhet banjëzimi i fidanit. Kjo realizohet në një enë ose gropë, në të cilën është përgatitë solucion bajgë e

freskët + ujë. Për këtë qëllim merren fidanat me kujdes (një nga një) zhyten me rrënjë në solucion dhe vihen tufa (kujdes mos të zhyten pjesët vegetative).

- Fidanët e gatshëm për mbjellje shpërndahen në rresht dhe me anë të një kunji mbillet direkt në fushë, drejtimi i rreshtave mbahet nga një spango e vendosur më parë sipas largësisë që do mbillen. Hapet vrima me kunjë në mënyrë që fidani të hyjë lirshëm në të; vendoset fidani 5-6 cm më thellë se në farishte dhe me anë të kunjit bëhet shtërgimi i tij në pjesën e poshtme afër sistemit rrënjor. Nëse toka është e tharë menjëherë bëhet ujitja duke hedhur 200-300 gr/ujë për bimë afër rrënjës pa lagur pjesët vegetative të bimës.

DDrejtorja e Teknologjive Bujqësore, QTTB-Shkodër,
E-mail: qttbshkoder@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

MASTITET NË LOPË

nëpërmjet:

- Duarve gjatë mjeljes;
- Linjave të mjeljes;
- Këtu perfshihen:
- Staphilococcus Aureus;
- Staphilococcus Agalactie;
- Corguabacterium Borie;

Ndërsa mykoplazmat shpërndahen në formë aerosolësh.

Infeksionet intramamare përshkruhen:

- Klinike
- Subklinike (raste më të lehta)

Si burime përhapëse të infeksionit konsiderohen:

- Shtresa që përdoret për mbarështim
- Uji që përdoret për larjen e gjirit në mjelje
- Peshqirët ose pecetat e gjirit
- Lesionet e lëkurës
- Traumat e thithit
- Gropa uji (lluce) të ndenjur
- Mjella e keqe
- Të ushqyerit e paballancuar

Praktika aseptike përbën një regjim që synon:

- Prodhim qumështi të pastër
- Ritje e prodhimit të qumështit
- Përmirsimi i kushteve dhe mirëmbajtjes të kafshëve
- Ulje e rasteve me mastite

SHENJAT

Raste të lehta

- Mund të ketë pak skuqje të gjirit;
- Mund të ketë temperaturë të gjirit;
- Mund të ketë pak dhimbje në mjelje;
- Qumështi është më i hollë;

Raste më të avancuara

- Gjiri është i forcuar;
- Gjiri është i skuqur;
- Gjiri është i dhimbshëm;
- Qumështi është viskoz dhe mezi del;
- Mund të ketë pika gjaku;
- Lopët janë të shqetësuar;
- Lopët mund të kenë diare;
- Qumështi përmban disa kokrriza;

Në analizat laboratorike qumështi i mjelë nga një gjiri normal ka 50,000 qeliza somatike për ml.

Në rastet kur numri i qelizave somatike arrijnë mbi 200,000 qeliza somatike për ml kemi të bëjmë me mastit.

Në raste shumë të rënda kur neglizhohet dhe mjekimi gjiri thahet.

Ka raste akoma më të rënda kur mastiti i zakonshëm komplikohet me një agjent tjetër mikrobik dhe kalon në gangrenoz i cili mund të ketë edhe pasoja fatale për lopën.

Mastiti është sëmundje e higjenës së dobët dhe papastërtisë.

Në këtë rast merr rëndësi të dorës së parë parandalimi i sëmundjes.

Është shumë e rëndësishme të kuptohet nga fermerët që mënyra më e mirë për eliminimin e sëmundjes së mastitit nuk është mjekimi por parandalimi i saj. Me pak kujdes dhe vëmendje duke zbatuar me përpikmëri rregullat normale të higjenës kjo sëmundje mund të shmanget. Po paraqesim disa momente të cilat duhen mbajtur parasysht gjatë punës:

- Gjiri duhet mbajtur i pastër sidomos para dhe pas mjeljes.
- Mjella duhet të bëhet me duar të pastra.
- Shtrati i lopës gjithashtu duhet të jetë i pastër dhe shtresa duhet ndërruar herë pas here.
- Lopët në tërësi duhet të jenë të pastra dhe të shëndetshme.
- Ato duhet të ruhen edhe nga sëmundje të tjera infektive.
- Gjiri i lopës duhet të masazhohet mirë para mjeljes dhe të milen edhe pikat e fundit të qumështit.
- Uji për masazhin dhe pastrimin e gjirit duhet të jetë i pastër.
- Peshqirët dhe picetat për tharjen e gjirit duhet të jenë të pastra.
- Të ushqyerit e lopëve duhet të jetë i ballancuar. Ushqimi nuk duhet të jetë i mykur.
- Tharja duhet të bëhet ngadalë gjithmonë sipas rregullave të përcaktuara.
- Pas mjeljes kanali i gjirit mbetet i hapur për

një farë kohe, (rreth 20 minuta). Është mirë që lopët të rrinë në këmbë gjatë kësaj kohe. Kjo arrihet duke ju hedhur ushqimin.

• Pas mjeljes është mirë që lopët brënda 90 sekondave të largohen nga salla e mjeljes, për të shmangur kontaminimin e thithës.

• Thitha duhet të spërkatet me dizinfektant brënda 1 minute pas mjeljes.

• Duhet bërë kontrolli individual i qumështit për çdo lopë për të kapur shenjat e hershme të mastitit

Trajtimi i Mastiteve

Në rastet e lehta nuk rekomandohet përdorimi i antibiotikëve. Sëmundja mund të kalojë me një mjellje të shpeshtë dhe të rregullt



duke përdorur gjithashtu edhe një lloj masazhi të lehtë të gjirit në fillim me ujë të ngrohtë e më pas me ujë të vakët.

Në rastin kur sëmundja ka avancuar rekomandohet përdorimi i antibiotikëve por njëkohësisht të shoqërohet edhe me mjellje të shpeshtë dhe masazh të gjirit.

Në këto raste duhet përjashtuar konsumi i qumështit nga njerëzit dhe të bëhet kujdes për pastrimin e vendit ku është derdhur qumështi i prishur për arsye se bëhet burim infeksioni për lopët e tjera.

Dëmi që shkakton sëmundja e mastitit është i konsiderueshëm dhe nuk duhet neglizhuar. Për të parë dëmin që shkakton sëmundja e mastitit po bëj një llogari të vogël. Vetëm nga një thithë e prishur brenda një jave fermeri humbet 2,000 lekë (të reja) për qumështin e humbur. Po të llogarisim edhe shpenzime të tjera si për mjekimin, dizinfektimin e pasojave të tjera dëmi arrin deri në rreth 20,000 lekë (të reja) në vit. Ndërsa për raste shumë të rënda shpenzimet kapin shifra të tjera.

Përgatiti: Flamur Shabani

Drejtorja e Teknologjive Blegtorale, QTTB-Fushë Krujë:
E-mail: qttbfushekrue@yahoo.com

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL


DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

Përhapja Miza e frutave ose miza Mesdhetare (*Ceratitis capitata* (Éied.) (Diptera: Tephritidae) e ka origjinën nga brigjet e Afrikës Perëndimore, por me kalimin e kohës ka kolonizuar çdo kontinent (përveç Antarktidës), madje është gjetur në pothuajse të gjitha zonat tropikale, sub-tropikale. Kjo shpërndarje e gjerë është arritur në sajë të nivelit të lartë të përshtatshmërisë, potencialit të lartë të saj riprodhues dhe njihet për polifaginë mjaft të shprehur (ushqehet me më shumë se 260 lloje të ndryshme pemësh, duke përfshirë edhe agrume, bërthanorë, (Thomas, 2005).

Këto karakteristika e kanë bërë atë një nga dëmtuesit më të dëmshëm që ndikojnë në agrikulturën. Në botë preken rreth 7.000.000 ha agrume dhe 1.400.000 ha fruta të tjera të ndjeshme ndaj *Ceratitis* (MAPA, 2009). Shkalla e saj është përkeqësuar edhe më tej në vitet e fundit për shkak të zgjerimit të kultivimit të varieteteve të agrumeve shumë të herëshme, sidomos Clementinë Marisol, e cila është jashtëzakonisht e ndjeshme dhe që arrin pjekurinë e plotë gjatë periudhës së tetorit, kur ende hasen shpesh temperatura optimale që favorizojnë qëndrueshmërinë e mizës.


Biologjia dhe cikli i jetës Insekti i rritur është pak më i vogël në përmasa në krahasim me atë të shtëpisë, me krahët e brendshme transparente, por me tri vija të verdha tërthorazi. Barku është i verdhë në kafe dhe kraharori është i zi me pika ngjyrë argjendi.



Vezët janë ngjyrë krem, ndërsa larvat rreth 9 mm në gjatësi, janë të bardha me kokën e sheshtë. Papat kanë formë cilindrike, ngjyrë kafe dhe rreth 4mm gjatësi. Aktiviteti i mizës në frut varet direkt nga temperatura, ajo është më aktive në temperatura midis 25 dhe 32° C.

Pas çiftëzimit, femra vendos 5-10 vezë në fruta të pjekur dhe është në gjendje të vendosë 800 vezë gjatë jetës së saj. Larvat arrijnë të maturohen si femra brenda vitit.

Cikli zakonisht zgjat rreth 40 ditë (Figura 2).



Dëmet. Femra shpon me ovopozitor një hapesirë të vogël në frut që shërben si portë hyrëse për insektet e tjera dhe për zhvillimin e kërpudhave, kalbëzimit etj (Figura 3).

MIZA MESDHETARE E FRUTAVE (CERATITIS CAPITATA)



- Larva shkakton ulje të cilësive organoleptike dhe zvogëlim të tulit të frutit, e cila krijon shumë problem (kalbëzim) në frutat me madhësi të vogël si, (mandarinat).

- Nxit rënien e parakohshme të frutave për shkak të infeksioneve shkaktuar nga metabolizmi sekondar i larvave.

- Edhe pse nuk arrihet dëmtim i plotë i frutit, fakti që në frut ka dëmtim, ka humbje vlerash tregtare dhe mund të shkaktojë rënie të shitjes në treg të prodhimit.

Çdo dëmtim i tillë shkakton një përkeqësim në cilësinë e frutave, si dhe një kërcënim real për eksport dhe marketing, prandaj, marrja e masave në kohë për luftimin i këtij dëmtuesi është i detyrues dhe shumë efikas.

Strategjitë e kontrollit

Deri me sot, për kontrollin e dëmtuesve në shumicën e kulturave, metodat e përdorura në përgjithësi kanë qenë trajtimet konvencionale ose kimike. Trendi i tanishëm, ka sjellë futjen e metodave alternative për kontrollin kimik që janë njëlloj të efektshme, për mjedisin dhe shëndetin, për fermerin dhe konsumatorin.

Rregullorja aktuale Evropiane (848/2008), që zëvendëson Direktivën 91/414/EEC, promovon një përdorim të qëndrueshëm të pesticideve, me qëllim reduktimin e impaktit të tyre për përmirësimin e sigurisë së njeriut dhe të mjedisit. Këto rregulla, krijojnë mundësinë për futjen e sistemeve të reja të kontrollit alternativ në fushën e bujqësisë. Në lidhje me kontrollin e dëmtuesve të mizës mesdhetare, strategjia është përdorimi gjithnjë e sa më pak i pesticideve të cilat depoizohen në frut (Malathioni, Dichlorvos etj).

Trajtimet me insekticide

Trajtimet ajrore zbatohen nëpërmjet spërkatjes, që përmbajnë një sasi shumë të vogël insekticide (malatión), proteina të tretshme në ujë dhe proteina, duke e aplikuar normalisht në grup. Rregullorja e re e BE përjashton përdorimin e trajtimeve ajrore, me përjashtim të rasteve shumë të veçanta.

Trajtimet kimike konvencionale mund të aplikohen në të gjithë pemën me proteina të tretshme në ujë të përzier me një insekticid përgjithësisht me organofosforik (Malathion) ose pyrethroid. Sot, rregullat e BE janë për eliminimin e fenitron, trichlorfon dhe Malathion. Përdorimi i insekticideve në fruta nënkupton kosto ekonomike shumë të lartë, humbje në cilësinë e frutave për

shkak të mbetjeve të kimikateve toksike, si dhe një çekuilibër ekologjik në zonën e trajtimit

Métodat agroteknike

